

Ftesë për Ofertë

Shërbime për rekuperimin e kredive të papaguara të debitorëve për nevoja të FINCA Kosovës

Numri i prokurimit FINCA – 104/20

HYRJE

FINCA Kosovë planifikon që një pjesë të portofolit nga huat e shlyera të bartë tek një palë e tretë ku më pastaj menaxhimi i ketyre rasteve do të bëhet nga pala e tretë duke respektuar praktikat e mira në treg si dhe ligjet apo rregulloret përkatëse të përcaktuara nga Banka Qëndrore e Kosovës. Gjithashtu, FINCA Kosoveë është Institucion i certifikuar me “Smart Certificate” ku kujdesi ndaj klientit është një ndër prioritetet e Insitutucionit.

KUSHTET DHE KËRKESAT

- Shërbimet duhet të jenë me kualitet të lartë dhe me çmime të volitshme, TVSH-ja duhet të jetë e përfshirë brenda çmimit.
- Çmimet të kuotohen në Euro (€).
- Ofertuesi duhet të paraqes një përmbledhje të planit dhe metodologjisë së punës e cila garanton respektimin e parimeve SMART, respektimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjeve tjera të aplikueshme.
- Ofertuesi duhet të paraqes strukturën organizative dhe funksionale dhe një përmbledhje për metodologjinë për trajtimin e ankesave.
- Ofertuesi duhet të ketë staf të kualifikuar ligjor për përfaqësim në procedurë përmbaremore.
- Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit.
- Eksperienca e ofertuesit për punë të ngjashme (të bashkangjiten së paku tre referenca nga Institucionet me reputacion në Kosovë të cilat vërtetojnë se Ofertuesi ka kryer punë të ngjashme ashtu si parashihet në Kontratë).
- Adresa e plotë dhe detajet për kontakt të Ofertuesit.
- FINCA Kosovë mban të drejtën për të bërë ndryshimin në specifikime, të anulojë këtë Tender, të riftojë pjesëmarrësit individual për të riparaqitur ofertën e tyre, të diskualifikojë një ofertues pa dhënë njoftim apo arsye.
- FINCA Kosovë mban të drejtën që të kërkojë informata shtesë nga kompanitë ofertuese.
- Kompania e përzgjedhur duhet të jetë e gatshme të ofrojë shërbimet në kohën kur FINCA Kosovë e konsideron të nevojshme.
- Ofertat të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë dokument, mund të diskualifikohen nga procesi i përzgjedhjes.
- Asnjë shpenzim që bëhet gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kuotimit të çmimit nuk do të kompensohet nga FINCA Kosovë.
- Ofertuesi fitues do të obligohet të sjellë certifikatën gjyqësore.
- Kriteret për përzgjedhje në këtë Tender bazohen në vendimin e Komisionit për Tender dhe të Bordit Menaxhues.

Oferta duhet të vendoset në zarf të mbyllur dhe të dorëzohet në zyrë qendrore të FINCA Kosovës, për Departamentin e Administratës dhe e shënuar qartë me numër të Tenderit në adresën:

Robert Doll Nr. 112, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Për informata shtesë ju lutemi kontaktoni përmes emailit në: info@fincakosovo.org

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është e enjte, 20.08.2020 në orën 16:00.